

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	SHBA po planifikon hyrjen ushtarake në Kubë - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/shba-po-planifikon-hyrjen-ushtarake-ne-kube/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 20:19:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 20:18:06 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a8b32ee17af661d71fc3656ed6fd7d88d2b4c2cb7e0b88df6c03e6222c02afad
TEKSTI	0ca3ef901d16d5df7397be00e1c35ead7f8a7708d72895fa2461d2e1fe1ce07a
PAMJA	c9230792b5e8efedc9ced699e858351e7bd996125d2ca5d07f21e9a7941f6ab5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	24e53db5d15347ea01bad0311016241521f42511b545a719a381491ba67ddfe2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f25232b47d2959dc6146897981a0af4e37060d45058c64d9459ab0f54fd17f54
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/24e53db5d15347ea01bad0311016241521f42511b545a719a381491ba67ddfe2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Edi Rama Donald Trump SHBA Gjyqi i UÇK KLGJ

BOTA | LAJM KRYESOR

SHBA po planifikon hyrjen ushtarake në Kubë

25 Shtator 2026 | 22:18

Ushtria amerikane po shqyrton vendosjen e njësive mjekësore, logjistike dhe të policisë ushtarake, ndërsa Pentagoni mban gati planet për veprime të mundshme në Kubë, raporton ekskluzivisht rrjeti amerikan i transmetimeve CBS.

Ushtria e Shteteve të Bashkuara thuhet se po ndërmerr hapa përgatitorë për një operacion të mundshëm që përfshin Kubën, sipas një ekskluziveje të botuar të premtën nga CBS News, e cila mori një mesazh të brendshëm të Ushtrisë dhe foli me disa zyrtarë amerikanë të njohur me planet.

Rezerva e Ushtrisë Amerikane po shqyrton nëse mund t'i ofrojë Komandës Jugore të SHBA-së forca të Policisë Ushtarake, staf mjekësor dhe njësi të tjera mbështetëse brenda një periudhe prej 90 deri në 120 ditësh, sipas dokumentit të shqyrtuar nga CBS News.

Mesazhi i brendshëm nuk e përmend në mënyrë të qartë Kubën. Megjithatë, disa zyrtarë amerikanë i thanë medias, në kushte anonimiteti, se kërkesa është pjesë e planifikimit ushtarak që Shtetet e Bashkuara po kryejnë në lidhje me ishullin.

Për momentin, nuk ka asnjë tregues se ndonjë njësi është urdhëruar të dislokohe, dhe dokumenti nuk specifikon se ku do të dërgohen forcat ose në çfarë lloj operacioni do të marrin pjesë.

Njësitë mjekësore, logjistike dhe të policisë ushtarake

Sipas rrjetit amerikan, dokumenti kërkon informacion mbi disponueshmërinë e gjashtë llojeve të njësive që mund të vendosen nën autoritetin e Komandës Jugore të SHBA-së, e cila është përgjegjëse për operacionet ushtarake amerikane në Amerikën Qendrore, Amerikën e Jugut dhe Karaibe.

Këto përfshijnë njësi të specializuara në logjistikë, transport, mirëmbajtje, karburant dhe furnizime, si dhe një batalion xhenierësh.

Kërkesa mbulon gjithashtu një brigadë mjekësore, ekupe të afta për të ofruar ndërhyrje kirurgjikale dhe trajtim emergjent për trupat e plagosura pranë forcave të dislokuara, dhe një brigadë të Policisë Ushtarake, që përdoret zakonisht për siguri, paraburgim dhe detyra të tjera policore.

Një zëdhënës i Komandës Jugore i kontaktuar nga CBS News nuk pranoi të jepte detaje mbi

LAJMI I FUNDIT

22:02 **Kepi: Kurti u ftua në mbrëmjen gala ku mori pjesë Rama, por nuk erdhi**

22:01 **"Më mirë një grua pak tërheqëse, por besnike, sesa..." ,deklarata që trazoi politikën italiane**

22:00 **Franca dërgon trupa në Arabinë Saudite**

21:57 **Zelensky: SHBA po shtyn tre hapa për rinisjen e diplomacisë me Rusinë**

21:54 **Kili sekuestron mbi 200 fosile në një kontejner nga Madagaskari: Të zhdukura rreth 66 milionë vjet më parë**

21:47 **Putin: Gati për bisedime me Kievin pas zgjedhjeve, por Ukraina do të vuajë pasojat e sulmeve ndaj civilëve**

TESTIM

lëvizjet e mundshme ose afatet kohore të vendosjes për arsye sigurie operationale dhe tha se komanda vlerëson vazhdimisht nevojat ushtarake brenda zonës së saj të përgjegjësisë.

‘Një vend i vogël fqinj’ që nuk përbën kërcënim

Raporti vjen pas muajsh tensionesh në rritje dhe kërcënimesh nga Presidenti i SHBA-së Donald Trump, i cili këtë javë i tha Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së se Kuba “është një shtet i dështuar” dhe se “do të bjerë”.

Ndërkohë, Ministri i Jashtëm Kubanez Bruno Rodríguez deklaroi në një intervistë me NBC News të premten se Shtetet e Bashkuara “nuk do të jenë kurrë në gjendje të gjejnë justifikim” për nisjen e një sulmi ushtarak kundër Kubës dhe hodhi poshtë idenë se ishulli do të pësonte të njëjtin fat si Venezuela:

“Qeveria amerikane nuk do të jetë kurrë në gjendje të gjejë justifikim ose çfarëdo arsye për të nisur një sulm ushtarak kundër një vendi të vogël fqinj që në asnjë mënyrë nuk përbën kërcënim për sigurinë e tij kombëtare”, pohoi ai./Euronews.com

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

BOTA

Franca dërgon trupa në Arabinë Saudite

Franca do të dërgojë trupa, radarë dhe sisteme mbrojtëse në Arabinë Saudite, në kuadër të një marrëveshjeje të finalizuar mes Parisit dhe Riadit. Lajmin e...

22:00 | 25/09/2026

BOTA

Zelensky: SHBA po shtyn tre hapa për rinisjen e diplomacisë me Rusinë

Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, ka deklaruar se administrata e presidentit amerikan Donald Trump po shtyn përpara tre hapa konkretë që synojnë uljen e tensioneve dhe...

21:57 | 25/09/2026

BOTA

Kili sekuestron mbi 200 fosile në një kontejner nga Madagaskari: Të zhdukura rreth 66 milionë vjet më parë

Zyrtarët doganorë në Kili zbuluan dhe sekuestruan më shumë se 200 fosile molusqesh të zhdukura. Ato u zbuluan në një kontejner transporti nga Madagaskari, i...

21:54 | 25/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Follow Euronews on all platforms: